

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Mirëqenies Sociale, Maj 2025

20.06.2025

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin maj 2025.

Bie numri i përfituesve nga ndihma sociale në maj 2025, krahasuar me maj 2024

Numri i përfituesve nga skemat pensionale dhe skemat e tjera të mirëqenies sociale

	Muaji/Viti		05/2025
	05/2024	05/2025	05/2024
Skema e ndihmës sociale	19,364	16,759	-13.5
Pensionet bazike të moshës	148,030	156,282	5.6
Pensionet kontributpaguese të moshës	48,630	47,517	-2.3
Pensionet e personave me aftësi të kufizuara	19,867	20,839	4.9
Pensionet e Trepçës	1,255	998	-20.5
Pensionet e Forcave të Sigurisë së Kosovës	819	886	8.2
Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës	1,342	1,374	2.4
Skema e të verbërve	1,862	1,843	-1.0
Pensionet Familjare	2,900	2,650	-8.6
Pensionet e Invalidëve të punës	43	33	-23.3
Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike	3,028	3,365	11.1
Skema e kompensimit për punëtorët e arsimit për vitet 90/91 deri në 98/99	13,924	14,569	4.6
Pensionet e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës	12,840	12,592	-1.9
Veteranët	36,971	36,492	-1.3
Skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara	3,425	3,802	11.0

Rënie e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin maj 2025, krahasuar me muajin maj 2024, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet invalidore (-23,3%); skema për pensionet e Trepçës (-20,5%); skema e ndihmës sociale (-13,5%); skema për pensionet familjare (-8,6%); skema e pensioneve kontribut-paguese të moshës (-2,3%); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-1,9%); skema për veteranët e luftës (-1,3%); skema e kompensimeve për personat e verbër (-1,0%).

Rritje e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin maj 2025, krahasuar me muajin maj 2024 kishte rritje të numrit të përfituesve nga: skema për Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike (11,1%); skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (11,0); skema e pensioneve të Forcës së Sigurisë së Kosovë (8,2%); skema e pensioneve bazike të moshës (5,6%); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (4,6%); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (4,9%); skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (2,4%).

Për më shumë informata lidhur me Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin Maj 2025, vizitoni:
<https://ask.rks-gov.net/Themes/SocialWelfare>